



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 837 Prot.

Tiranë, më 10.06 2019

**VENDIM Nr. 155, datë 6.06.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 6.06.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim të projektit *"Rikonstruksion fasade, shtesë kati+shtesë anësore (Kafazi i shkallëve) në taracë dhe restaurimi i vilës "ARTUR TERZIU", në lagjen Nr. 1, rruga "Vangjel Toçi" zona arkeologjike "A" Durrës"*, subjekti Z. Artur Terziu,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zhvillimin e projektit *"Rikonstruksion fasade, shtesë kati+shtesë anësore (Kafazi i shkallëve) në taracë dhe restaurimi i vilës "ARTUR TERZIU", në lagjen Nr. 1, rruga "Vangjel Toçi" zona arkeologjike "A" Durrës"*, subjekti Z. Artur Terziu, me kushtin që zhvillimi i sipërpërmendur nuk duhet të ndikojë tek themelet ekzistuese të cilat nuk duhet të preken, si edhe të respektojë rigorozisht kushtin e moscënimit të territorit, të përcaktuar në VKM Nr. 786, datë 26.12.2018.
2. Subjekti Z. Artur Terziu, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, subjekti Z. Artur Terziu duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për fillimin e punimeve. Këto punime sipas fazave të zbatimit të projektit do të monitorohen nga DRKK Durrës, e cila duhet të depozitojë pranë ASHA informacionin në lidhje me to.
4. Në rast të domosdoshmërisë së kryerjes së punimeve të infrastrukturës inxhinjrike, të paparashikuara për projektin e sipërpërmendur, subjekti Z. Artur Terziu duhet të njoftojë zyrtarisht DRKK Durrës dhe ASHA. Ai duhet të lidhë paraprakisht, akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Durrës, e cila do të monitorojë në mënyrë periodike ditore kryerjen e këtyre punimeve, si dhe ASHA që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre.

5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITË  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**